



THIRRJE PËR PROJEKT - PROPOZIME

MBËSHTETJE PËR ZHVILLIMIN E BIZNESIT ME FONDE PËR VITIN 2025

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit hapi thirrjen për aplikime për mbështetje financiare me fonde për një nga skemat e mëposhtme:

SKEMA 1: MBËSHTETJE FINANCIARE PËR SHPENZIME KORRENTE

Vlera e financimit deri në 2,500,000 lekë;
Mbulimi i kostove 100%

SKEMA 2: MBËSHTETJE FINANCIARE PËR SHPENZIME KAPITALE

- PROJEKTE PËR KONKURRUESHMËRINË: Vlera e financimit deri në 1,500,000 lekë; Mbulimi i kostove 100%;
- PROJEKTE PËR ARTIZANATIN: Vlera e financimit deri në 1,000,000 lekë; Mbulimi i kostove 100%.

Thirrja qëndroi e hapur deri më 28 shkurt 2025, ora 14:00.



Takime informues për Fondin “Mbështetje për Zhvillimin e Biznesit”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) organizoi takimet informuese për Fondin “Mbështetje për Zhvillimin e Biznesit” për subjektet në Tiranë, Durrës, Shkodër, Lezhë, Korçë, Vlorë, Fier dhe Gjirokastrë.

Gjatë takimeve, pjesëmarrësit u njohën me kriteret dhe kushtet e 2 (dy) skemave të mbështetjes, si dhe morën përgjigje të detajuara mbi procesin e aplikimit.





Match-Maker Albania 2025 është ngjarja që nuk duhet ta humbisni!

Find the Right Match – Unlock the Opportunity!
27 Mars 2025–Pallati i Kongreseve, Tiranë

Ky event do të jetë një mundësi e jashtëzakonshme për të lidhur eksportuesit shqiptarë me tregjet ndërkombëtare, për të prezantuar investime vendase dhe të huaja në Shqipëri, për të shfaqur potencialin e vendit tonë dhe për të krijuar bashkëpunime të reja me kompani globale.

Një sërë ngjarjesh biznesi pritet të ndodhin në këtë event, ku në një vend të vetëm do bashkohen institucione, kompani dhe investitorë nga vende të ndryshme të botës, me synim krijimin e bashkëpunimeve të frytshme.

Rezervoni këtë datë dhe bashkohuni me ne për të zbuluar mundësitë e reja që na presin!

Regjistrohu në link:

<https://forms.office.com/e/YTeePR6vzd>

Kick-off Meeting: bëhemi gati për aktivitetin e madh të datës 27 Mars.

Gjatë muajit Shkurt AIDA zhvilloi 2 takime Kick-off Meeting per Match-Maker Albania 2025!

Takimet, drejtuar nga Znj. Laura Saro, Drejtor Ekzekutiv i AIDA, u zhvilluan për të folur për aktivitetin e datës 27 Mars dhe qasjen që do të kenë në këtë event eksportuesit shqiptarë.

AIDA është e përkushtuar për të avancuar investimet e huaja, për të mbështetur rritjen e eksporteve dhe për të nxitur konkurrencën e sipërmarrjeve shqiptare.

Për të realizuar me sa më efektivitet eventin tonë të ardhshëm Match-Maker Albania, një ngjarje kryesore njëditore që do të mbahet në Tiranë më 27 Mars 2025, do organizohen një sërë tryezash diskutimi me palët e interesit që do të marrin pjesë në organizimin eventit.



Produktet organike autentike “Made in Albania” në qendër të vëmendjes në BIOFACH 2025 në Gjermani!

Në pjesëmarrjen e saj të katërt në BIOFACH2025, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) mundësoi promovimin e eksporteve organike shqiptare në skenën globale të tregtisë.

Me mbi 2,300 ekspozues nga 94 vende dhe më shumë se 35,000 vizitorë nga 140 vende, të spikaturit në BIOFACH nuk ka të bëjë me madhësinë e stendës, por me ngjyrat, aromat, freskinë dhe autenticitetin e produkteve organike – ku Shqipëria tërhoqi vëmendjen dhe interesin e vizitorëve.

Ishim të nderuar të mirëprisnim vizita të nivelit të lartë, duke përfshirë Ministrin Federal Gjerman Z. Cem Ozdemir dhe Sekretaren e Shtetit për Ushqimin dhe Bujqësinë Znj. Silivia Bender, të cilët u ndalën në pavionin shqiptar.

-Çfarë e bëri BIOFACH 2025 të paharrueshëm?

Pasioni i palëkundur i prodhuesve shqiptarë, të cilët treguan përkushtimin e tyre pasionant ndaj bujqësisë organike.

Lidhjet e biznesit të ndërtuara përmes takimeve B2B, duke krijuar mundësi bashkëpunimi te reja, përtej marrëveshjeve të ekzistuese.

Njohja e Shqipërisë si një furnizues serioz i bimëve mjekësore dhe aromatike dhe vajit të ullirit në tregun organik evropian, duke dëshmuar se cilësia, qëndrueshmëria dhe autenticiteti kanë rëndësi paresore.

Një falënderim i madh për të gjithë ata që kontribuan në këtë pjesëmarrje të suksesshme – ekspozuesit tanë, partnerët tanë SIPPO Albania dhe ITC Trade Promotion East, dhe veçanërisht ekipin e AIDA, të cilët me përkushtimin e tyre siguruan një prezencë domethënëse të Shqipërisë në BIOFACH edhe këtë vit.



Shqipëria Promovon Verërat Autoktone në panairin Wine Paris 2025

Për herë të parë, Shqipëria ishte pjesëmarrëse me stendë të dedikuar në këtë panair, i cili është ndër aktivitetet më të mëdha ndërkombëtare për industrinë e verërave dhe pijeve alkoolike.

“Wine Paris” është një pikëtakim për tendencat, konceptet dhe idetë më të reja e inovative në fushën e verës, të cilat do të formësojnë suksesin e ardhshëm të kësaj industrie.

Shqipëria mori pjesë me sukses në Wine Paris 2025, ku prezantoi 20 etiketa premium nga varietetet e saj autoktone. Me 1,400 vizitorë në stendën shqiptare dhe rreth 25 kontakte potenciale, panairi shërbeu si një mundësi e rëndësishme për eksport dhe bashkëpunime të reja.

Në një event të veçantë, përfaqësuar nga Ministrija znj. Delina Ibrahimaj, z. Dritan Tola, Ambasadori i Shqipërisë në Francë, dhe Laura Saro, Drejtoreshë Ekzekutive e AIDA, u festua anëtarësimi i Shqipërisë në OIV, një hap historik për industrinë shqiptare të verës.



Trajnimi 3-ditor “Kërkim dhe Analizë” për eksportuesit shqiptarë u përmbyll me sukses

Pranë zyrave të AIDA-s u zhvilluan 3 takime ku pjesëmarrësit u njohën me rëndësinë e analizës së tregut, klasifikimin dhe origjinën e mallrave, si dhe bazën e të dhënave ITC për gjetjen e mundësive të reja të eksportit. Diskutimet dhe shembujt praktikë e bënë sesionin edhe më interaktiv dhe të vlefshëm për bizneset shqiptare.

Ky trajnim u fokusua në:

- Rëndësia e analizës së tregut.
- Gatishmëria për eksport dhe strategjitë për zgjerimin në tregje të reja.
- Panairët ndërkombëtare dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së bizneseve shqiptare.
- Misionet tregtare si mundësi për zgjerimin në tregje të reja.
- Platforma dhe strategjia për organizimin e takimeve B2B dhe matchmaking.

Pjesëmarrësit u pajisën me certifikata, duke përmbyllur me sukses këtë cikël trajnimesh që i pajisi me njohuri dhe mjete praktike për të forcuar prezencën e tyre në tregjet ndërkombëtare.

Falenderojmë të gjithë pjesëmarrësit për angazhimin dhe bashkëpunimin e tyre që u bënë pjesë e këtij trajnimi i mundësuar nga mbështetja e partnerëve tanë të GIZ Albania dhe ekspertizën e Damiani & Partners.

AIDA do të vijojë të mbështesë eksportuesit shqiptarë me trajnime dhe asistencë të dedikuar për të rritur mundësitë e tyre në tregjet ndërkombëtare.



AIDA mirëpriti një Delegacion Egjiptian biznesi, për të zhvilluar një sesion B2B

Gjatë takimit, Drejtoresha Ekzekutive e AIDA, znj. Laura Saro prezantoi mundësitë që Shqipëria ofron për investitorët, duke vënë në dukje se viti 2024 shënon deri tani shifrat më të larta sa i përket stokut të investimeve egjiptiane në Shqipëri dhe volumit tregtar.

Qëllimi i Delegacionit ishte identifikimi dhe krijimi i mundësive për bashkëpunim ekonomik të ndërsjelltë me kompanitë shqiptare në sektorë si pasuria e paluajtshme, energjia e rinovueshme dhe prodhimi e distribucioni i pajisjeve laboratorike, mjekësore e më gjerë.

Në këtë takim të pranishëm ishin: H.E. Hassan Shawky (Ambasadori i Egjiptit në Tiranë), H.E. Ambassador Khalid I. Emara (Anëtar i Këshillit Egjiptian për Punë të Jashtme), Dr. Sameh Harfoush (Kryetar dhe Drejtor Menaxhues i Sky Investments), Eng. Mahmoud Mohamed Ahmed (Kryetar dhe anëtar bordi i disa kompanive ndërtimi dhe industriale), Eng. Osama Shalaby Abu Sheasha (Bashkëthemelues dhe Drejtor Menaxhues i GIC dhe DCC)

Përfaqësues nga kompanitë shqiptare ishin Concord Investment (sektori i pasurive të paluajtshme); Vega Group (sektori i energjisë së rinovueshme) dhe Medical Distribution (distribucion i pajisjeve mjekësore).



AIDA së bashku me stafin e Drejtorisë së IHD-ve, Partneritetit dhe Kërkimit, mirëpriti përfaqësuesit e kompanisë Uklon.

Uklon është një kompani ukrainase që operon në sektorin e teknologjisë së informacionit, e specializuar në shërbimet e transportit me kërkesë (ride-hailing). Që prej vitit 2023, Uklon operon edhe në Tashkent, Uzbekistan.

Gjatë diskutimeve, përfaqësuesit e Uklon prezantuan modelin e tyre të biznesit dhe planet për zgjerim në Shqipëri. Përfaqësuesit e AIDA-s informuan kompaninë mbi klimën e investimeve në Shqipëri dhe mundësitë për rritje.

AIDA do të vijojë komunikimin me Uklon dhe të mbështesë investitorët e huaj në eksplorimin e mundësive që ofron Shqipëria, duke përfunduar angazhimin e saj për tërheqjen e investimeve të huaja dhe zhvillimin e ekosistemit të biznesit në vend.




Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vizitë zyrtare në Doha, Katar

AIDA mori pjesë në vizitën zyrtare organizuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme në Doha, Katar. Në këtë aktivitet të rëndësishëm të marrëdhënieve diplomatike dhe ekonomike mes dy vendeve, morën pjesë edhe AIC, TEDA Tirana, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, si dhe biznese shqiptare që kanë interes bashkëpunimin me Katarin.

Takimet zyrtare filluan në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Katarit, më pas aktiviteti me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Katar dhe Bankës për Zhvillim. Në këtë ngjarje AIDA prezantoi klimën e investimeve në vend dhe ftoi bizneset dhe autoritetet që ndoqën aktivitetin të vijnë në Shqipëri për të eksploruar mundësitë për investime dhe bashkëpunime.

Bizneset Shqiptare zhvilluan në këtë aktivitet sesione B2B me bizneset vendase. Takimet vijuan në Katari Diar, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe Autoritetin e Investimeve të Katarit.

Katari është një vend kyç i Gjirit Persik dhe interesi për shtrirjen e bizneseve të Katarit, partneriteteve afatgjata dhe të qëndrueshme që nxisin rritjen ekonomike dhe inovacionin, është i mirëpritur në vendin tonë.



Marrëveshje e re për zhvillimin e biznesit mes Shqipërisë dhe Turqisë!

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), e përfaqësuar nga Drejtoresha Ekzekutive znj. Laura Saro, dhe MÛSIAD Albania (Shoqata e Industrialistëve dhe Biznesmenëve të Pavarur nga Turkiye), e përfaqësuar nga Kryetari z.Muhammet İşler, nënshkruan sot një Memorandum Mirëkuptimi.

Qëllimi i këtij memorandumi është bashkëpunimi për të kontribuar në zhvillimin ekonomik, si dhe në përmirësimin e marrëdhënieve tregtare dhe kulturore në botën e biznesit të të dy palëve përmes organizmit të aktiviteteve nga MÛSIAD Albania dhe AIDA.



Drejtoresha Ekzekutive e AIDA, znj. Laura Saro, priti në një takim Z. Neritan Mullaj, Drejtorin Ekzekutiv të American Chamber of Commerce in Albania.

Gjatë takimit u diskutua rreth bashkëpunimit për eventin Match Maker Albania që do të zhvillohet në datën 27 Mars.

Vëmendje e veçantë iu kushtua përforsimit të marrëdhënieve ekonomike mes dy vendeve.

Ky bashkëpunim synon të nxisë zhvillimin ekonomik dhe të forcojë lidhjet mes Shqipërisë dhe Amerikës.

AIDA mirëpriti Sh.T.Z. Jakob Stunf, Ambasadorin e Sllovenisë në Shqipëri

Drejtoresha Ekzekutive e AIDA, znj. Laura Saro, priti në AIDA Sh.T.Z. Jakob Stunf, Ambasadorin e Sllovenisë në Shqipëri.

Takimi kishte si qëllim prezantimin dhe diskutimin e potencialeve të dy vendeve si destinacione investimesh, si dhe prezantimin e sektorëve kyç ekonomik të dy vendeve.

Gjatë takimit u diskutua mbi mundësitë dhe lehtësimin e shkëmbimeve tregtare, duke ndikuar në fuqizimin e biznesit vendas përmes bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve.

Ky bashkëpunim synon të nxisë zhvillimin ekonomik dhe të forcojë lidhjet mes Shqipërisë dhe Sllovenisë.



TEDA Tirana – Zonë e Zhvillimit Teknologjik dhe Ekonomik

TEDA Tirana – Zonë e Zhvillimit Teknologjik dhe Ekonomik

Një zonë zhvillimi teknologjik dhe ekonomik e klasit botëror, e projektuar për investime të mundshme nga industritë që përdorin teknologji të avancuar dhe kanë njohuri të mëdha të produkteve në industrinë e Automobilitave, TIK-ut dhe Elektronikës.

TEDA Tirana është një projekt i ri në një vendndodhje strategjike që mundëson të gjitha lehtësitë e infrastrukturës.



Mundësi Trajnimi Falas për Ndërmarrjet që Synojnë Eksportin në Suedi dhe BE

AIDA ju informon se në datat 11 Mars – 30 Prill 2025 do të zhvillohet një trajnim si një mundësi shumë e mirë për bizneset shqiptare që dëshirojnë të rrisin kapacitetet e tyre eksportuese dhe të shfrytëzojnë potencialin e tregjeve europiane.

Trajnim Digjital -Ky trajnim i organizuar nga Open Trade Gate Sweden (OTGS) ofrohet falas dhe synon të pajisë bizneset me njohuri dhe aftësi kyçe për të përmirësuar konkurrueshmërinë e tyre në tregjet ndërkombëtare.

Për t'u regjistruar dhe për më shumë informacion, ndiqni këtë link: <https://trk.idrelay.com/2960/web...>



Ftesë për pjesëmarrje në ekspozitën BEYOND 2025

Bëhuni pjesë e udhëtimit dhe lini gjurmët tuaja në ekspozitën më të madhe të teknologjisë në Greqi-BEYOND 2025

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ju informon se BEYOND 2025 do të mbahet nga data 4 prill deri më 6 prill 2025, në Qendrën e Ekspozitave dhe Konferencave të Athinës, Metropolitan Expo.

BEYOND 2025 është një ekspozitë ndërkombëtare e teknologjisë dixhitale dhe inovacionit që këtë vit zhvillohet në Athens Metropolitan Expo. Qëllimi kryesor është të promovojë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e njohurive dhe ideve midis pjesëmarrësve dhe të nxisi zhvillimin e teknologjive inovative dhe mundësive të biznesit.

Mundësi e re për të siguruar një të ardhme të qendrueshme!



Panairi Ndërkombëtar i Turizmit Kosova 2025 – Edicioni i 4-të.

AIDA ju njofton për organizimin e Panairit Ndërkombëtar të Turizmit – KOSOVA 2025!

Me mbështetjen e Institucioneve të Republikës së Kosovës ky edicion pritet të mirëpresë rreth 350 kompani nga 16 vende, duke e bërë atë një platformë kyçe për promovimin e turizmit, forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe zgjerimin e rrjeteve të biznesit. Në këtë panair do të jenë pjesëmarrës organizata prestigjioze, përfaqësues shtetërorë dhe profesionistë nga sektori i turizmit.

Panairi do të zhvillohet si më poshtë:

Datat: 10–11 Prill 2025

Vendi: Prishtina Mall, Prishtinë

Kontribuoni në rritjen e përgjithshme të industrisë së turizmit!



AIDA, do të marrë pjesë në panairin ndërkombëtar “ITB BERLIN”, 4-6 Mars

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), do të marrë pjesë në panairin ndërkombëtar “ITB BERLIN”, në datat 4-6 Mars në Berlin, Gjermani si bashkë-ekspozuese krahas Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

ITB Berlin është panairi më i madh i turizmit në botë, i cili tërheq shumë ekspozues dhe pjesëmarrës dhe mbetet një platformë kyçe për rrjetëzimin, inovacionin dhe turizmin global. Gjithashtu luan një rol vital në formësimin e trendeve, politikave dhe partneriteteve në sektorin e turizmit.

Kompanitë e përfaqësuara në panair përfshijnë hotele, struktura akomoduese, operatorë turistikë, linja ajrore etj.

Shqipëria në këtë panair do të ketë vendin e nderit dhe AIDA do të marrë pjesë në rolin e institucionit përgjegjës për tërheqjen e IHD-ve në sektorin e turizmit si një ndër sektorët prioritarë dhe strategjikë në zhvillimin e vendit, duke prezantuar potencialet investuese të vendit tonë dhe paketat më të fundit incentive sektoriale.



AIDA merr pjesë për herë të dytë në Panairin FOOD EXPO 2025, Athinë

Food Expo 2025 është një mundësi e shkëlqyer për të eksploruar risitë dhe tendencat e fundit në industrinë e ushqimit dhe pijeve.

Panairi do të mirëpresë nga data 8 deri më 10 mars më shumë se 37,000 blerës nga e gjithë bota. 1,300 ekspozues – 250 prej të cilëve do të jenë pjesëmarrës ndërkombëtarë – pritet që ata të shfaqin risitë e tyre për mijëra profesionistë të industrisë Food&Beverages.

Panairi pritet të zhvillojë lidhje të reja të eksportit duke gjetur partnerë të mundshëm biznesi ndërmjet 2,500 tregtarëve ndërkombëtarë të ushqimit dhe pijeve dhe 1,000 blerësve të ftuar nga 83 shtete. AIDA merr pjesë për herë të dytë në këtë Panair dhe këtë herë do të shoqërohet nga 7 biznese shqiptare.

Pjesëmarrja në këtë edicion të rradhës vlen për të promovuar vendin si destinacion investimi dhe për të mbështetur bizneset shqiptare drejt ndërkombëtarizimit.

Data: 8-10 Mars, 2025

Vendndodhja: Metropolitan Expo, Athinë



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) do të marrë pjesë për herë të parë në MIPIM 2025

MIPIM 2025-Panairi më i rëndësishëm ndërkombëtar i pasurive të paluajtshme, duke prezantuar projekte të mëdha urbanistike dhe mundësi investimi në Shqipëri. Ky eveniment i rëndësishëm do të ofrojë mundësi për të promovuar zhvillimin e infrastrukturës dhe projekteve të reja që do të transformojnë qytetet shqiptare. AIDA synon të tërheqë investitorë të huaj dhe të krijojë mundësi bashkëpunimi për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit urbanistik në Shqipëri.

MIPIM 2025 do të bashkojë profesionistët e industrisë së pasurive të paluajtshme, zhvillimit urban dhe planifikimit.

Data: 10-14 March 2025

Vendndodhja: Palais des Festivals, Cannes, France

